L I G J
Nr.8083, datë 7.3.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7678, DATË 3.3.1993 "PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7797, DATË 23.2.1994, LIGJIN NR.7821, DATË 11.5.1994, LIGJIN NR.7901, DATË 15.2.1995 DHE LIGJIN NR. 8029, DATË 14.11.1995

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 3 i ligjit nr. 7678, datë 3.3.1993 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", ndryshohet si vijon:

"Mallrat e veçanta që tatohen me akcizë dhe përqindjet e tyre janë:

a) Duhan e prodhime duhani:	Përqindja e akcizës
- Cigare	50
- Puro	70
- Duhan për konsum	70
- Letër cigareje për shitje	50
b) Pije alkoolike - Birrë	40
- Verë	40
- Raki	70
- Konjak, uzo, fërnet, ponç, uiski, rum dhe të gjitha pijet e tjera alkoolike të importura	105
- Likernat e importuara	85
c) Pije të buta dhe freskuese	30
ç) Ujë mineral dhe i gazuar	20
d) Kafe	30
dh) Energji elektrike duke përjashtuar disa përdorues të sektorëve kryesorë të ekonomisë, sipas përcaktimit të Këshillit të Ministrave	50
e) Alkool etilik prodhim vendi me fortësi 95.5-96% për prodhim pije alkoolike si uzo, fërnet ponç, konjak, likerna etj.....	85
ë) Alkool etilik i pastër importi me fortësi 95.5-96% për prodhim pijesh alkoolike si uzo, fërnet ponç, konjak, likerna etj.....	110
f) Alkool etilik rrushi (distilat vere) me fortësi 68-70% për prodhim pijesh alkoolike.....	80

Personave juridikë a fizikë vendas dhe të huaj që prodhojnë për eksport pije alkoolike, vlera e akcizës së paguar në doganë ose në blerjet nga alkooli i prodhuar në vend i rimbursohet, për atë sasi alkooli të përdorur për prodhimin e pijeve alkoolike që eksportohen.

Përqindja e akcizës	
g) Nënproduktet e naftës:	
- Benzinë 45.89.9 oktan	60
- Benzinë 90 aktan e lart	50
- Gazoi	l40

- Vajguri prodhim vendi 16
- Valvolinë 80
- Vajra lubrifikante të të gjitha llojeve dhe grasot 80
- Të tjera (solar, mazut, koks nafte, bitum, gaz i lëngët, toluol, squfur, ksilol, solvent e artikuj të ngjashëm neto) 25

Përjashtohen nga akciza gazi i lëngët i importit për përdorim në popullsi, si dhe mazuti e solari të prodhuar në vend që përdoren për prodhim avulli për ngrohjen e popullsisë.

Për letrën e cigares, të importuar nga subjektet e ndryshme ekonomike dhe që duhet për nevojat e prodhimit, të mos zbatohet akcizë në doganë.

Merret në formë akcize edhe diferenca ndërmjet çmimit përfundimtar të shitjes dhe çmimit të caktuar nga organet shtetërore, duke i shtuar këtij të fundit për energjinë elektrike 50 për qind, përjashtuar disa përdorues të sektorëve kryesorë të ekonomisë dhe për nënproduktet e naftës përqindjet e caktuara në shkronjën "g" të këtij neni.

Për mallrat e përcaktuara në shkronjën "a", kur importohen zbatohet një akcizë plus 35 për qind nga ajo e caktuar më lart, përjashtuar cigaret, për të cilat zbatohet një akcizë plus 50 për qind, dhe për ato të shkronjës "b" plus 25 për qind (ku përfshihen birra, vera dhe rakia).

Neni 2

Ligj nr.7797, datë 23.2.1994 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7678, datë 3.3.1993 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr.7821, datë 11.5.1994 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7678, datë 3.3.1993 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar në ligjin nr.7730, datë 20.7.1993; neni 2 i ligjit nr.7901, datë 15.2.1995 "Për miratimin në ndryshim të dekretit nr. 982, datë 10.12.1994 "Për tatimin mbi qarkulimin", si dhe ligjin nr.7678, datë 3.3.1993 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë"; ligj nr. 8029, datë 14.11.1995, "Për miratimin e dekretit nr. 1242, datë 5.10.1995, Për një ndryshim në ligjin nr. 7678, datë 3.3.1993 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.7797, datë 23.2.1994, shfuqizohen.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi më 1 maj 1996.

Shpallur me dekretin nr.1418, datë 20.3.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha